



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TETO ZA RAZMATRANE NABAVKE

Nr./Br. 43/17

Datë/Datum. 06.02.2017

PRISHTINË - PRISTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW**

PSH. Nr. 43/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Lgjin Nr. 05/L-068 dhe Lgjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej: z. Ekrem Salihu - Kryetar, z. Tefik Sylejmani – Referues, z. Nuhi Paqarizi - anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE. “Besi” - Prishtinë, përfaqësuar nga z.Shekfi Selani, kundër autoritetit kontraktues-MKK-së, përfaqësuar nga z.Shaban Tafa, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKK-së” me numër të prokurimit: 211/16/274/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria për Kthim dhe Komunitete, më: 02.03.2017, mori këtë :

V E N D I M

- I. **HUDHET**, poshtë si e palejuar ankesa OE “Besi” – Prishtinë, me nr. 43/17, kundër vendimit të AK - Ministria për Kthim dhe Komunitete, për aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKK-së”, me numër të prokurimit: 211/16/274/221, pasi i njëjti nuk ka arritur të dëshmoj interes juridik - material konform nenit 111 par. 1 pika 1.5 dhe 1.8 të LPP-së, lidhur me nenin 4.1.26 të LPP-së, për shkak se i

njëjtë e ka tejkaluar vlerën e parashikuar, të publikuar në njoftimin për kontratë të datës: 05.12.2016, në ueb faqen e KRPP-së.

- II. **VËRTETOHET**, vendimi i AK - Ministria për Kthim dhe Komunitete, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKK-së” me numër të prokurimit: 211/16/274/221. Autorizohet Autoriteti kontraktues që të vazhdoj me tutje me këtë aktivitet te prokurimit.
- III. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankues “Besi” - Prishtinë, hudhet poshtë si e palejuar, konform nenit 118 të LPP-së, të njejtë i kthehet sigurimi i ankesës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik “Besi” - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 23.01.2017, me nr. të protokollit, 43/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE. “Suzuki” - Prishtinë, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së dhe ate nenit 1,59 dhe 61 të LPP-së.

Ankesa është e palejuar dhe e njejtë është parashtruar nga personi kompetent dhe është parashtruar brenda afatit të parapar ligjor.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues z.Visar Basha , për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës: 22.02.2017 ka konstatuar se AK-ja, i ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe se pretendimi ankimor i parashtruar në ankesë për zbatimin e rregullores për çmime Jo-Normalisht të ulëta, është i paqëndrueshëm, për faktin se, rregullorja në fjalë nuk

mund të aplikohet në rastin kur kemi vetëm një ofertë të përgjegjshme, prandaj, i ka propozuar panelit shqyrtues, që ta refuzoj ankesën e OE. ankues si të pa bazuar dhe njëherit i ka propozuar panelit shqyrtues që ta aprovoj vendimin e AK-së, si të bazuar.

OE ankues “Besi” - Prishtinë, përmes parashtresës ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

AK-ja, poashtu me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 02.03.2017, në të cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i autorizuar OE ankues, përfaqësuesi i AK-së. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e konratës, anesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigja e AK-së mbi raportin e ekspertizës.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE “Besi” z. Selani i cili deklaroj: Do doja të plotësoj referuesin se kemi bërë kërkesë për rishqyrtim mirëpo nuk ka pas letër standarde për eliminim. Ne kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues dhe kemi vërejt se mungojnë disa detaje. Së pari ai ka dhënë katër sqarime me ecurinë e këtij aktiviteti. Në të parën thotë – merr vetëm konstatimet e komisionit pa e cek se edhe dy OE tjerë kanë qenë të përgjegjshëm, dmth. konstaton komplet konstatimin e komisionit.

Pas njoftimit nga AK-ja, kemi bërë kërkesë pranë AK-js, për qasje në dokumente të OE fitues, dhe pasi do kalonte afati kërkesës për rishqyrtim, kemi bërë kërkesë për rishqyrtim një ditë para afatit për parashtrim të kërkesës. Oferta jonë ka kaluar buxhetin e paraparë nga AK-ja, për këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo është pa logjike dhe për mendimin tim e pamatshme çmimet e ofruara nga OE. i rekomanduar për kontratë. OE i rekomanduar 58.8% është më i ulët se vlera e parashikuar.

Në qasje në dokumente të OE. fitues kemi vërejt çmime, te cilat janë manipulative, si psh ora e punës 40€ për orë çka është çmim më i shtrenjtë për orë se paga e presidentit. Ne nuk dimë me çfarë parametra kanë bërë AK-ja, planifikimin e buxhetit, ndërsa një ndër kriteret kryesore ka qenë që çmimet e ofruara të janë ekuivalente me çmimet e tregut.

Qëndrojム në tërësi pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe i propozojム panelit që lëndën ta kthej në Rivlerësim".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-MKK-së, z. Tafa, i cili deklaroj: Sa i përket pretendimit ankimorë për nenin 61 të LPP-së, i jep të drejtën AK-së për të vendos për çmime jo normalisht të ulëta. Neni 61.4 i LPP-së, ku është përgjegjësi e AK-së, për çmime dhe njëkohësisht i obligon AK-të, që në rast se nënshkruan kontratë me OE. të merr edhe përgjegjësinë për atë kontratë.

Ne si AK, çmimet e OE. të rekomanduar kanë qenë çmime bindëse pasi me këtë OE. kemi pas kontratë më herët dhe kanë qenë çmimet e njëjta. Andaj nuk shohim diçka që duhet konsideruar si çmim jo normalisht i ulët.

Sa i përket pretendimit tjeter ankimorë edhe vet OE. ceku se për këtë aktivitet ka tejkaluar buxhetin e paraparë nga AK-ja, edhe pse buxheti i AK-së ka qenë i publikuar në njofimin për kontratë edhe është dashtë përafërsisht të bazohet OE, te vlera e paraparë.

Për të njëtin aktivitet edhe vitin e kaluar kemi pas ankesë me njëtat pretendime ankimore dhe është vendimi i OSHP-së në favor të AK-së për njëtat pika ankimore për të njëtin OE.

I propozojム panelit të aprovohet vendimi i AK-së dhe të refuzohet ankesa e OE. ankues pasi i njëjti është palë pa interes.

Kërkesa e OE. edhe po të kthehet lënda në rivlerësim, AK-ja, nuk mund të lidhë kontratë me këtë OE. pasi i njëjti ka tejkaluar buxhetin e paraparë prej AK-së".

Në vazhdim të seancës fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Basha i cili deklaroj: Tejkalimi i buxhetit prej OE ankues e bënë të papërgjegjshëm këtë OE për faktin se AK-ja, ka paraparë buxhet prej 52.000€ për cilat ka qenë i njofuar edhe vet OE ankues.

Sa i përket pretendimit lidhur me aplikimin e rregullores për çmime të ulëta, kjo rregulllore nuk mund të aplikohet pasi nuk janë tri oferta të përgjegjshme. Kjo është arsyaja kryesore pse kam rekomanduar të refuzohet ankesa dhe të aprovohet vendimi i AK-së".

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikës pretenduese të parashtreesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE. ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se OE. ankues nuk ka arritur te dëshmoj interes juridik e material në këtë aktivitet të prokurimit konform nenit 4.1.26 dhe nenit 111 të LPP-së, për

faktin se edhe gjatë seancës dëgjimore u vërtetua fakti se OE. ankues e ka tejkaluar vlerën e parashikuar në njoftimin për kontratë dhe këtë fakt e pranoj edhe vet përfaqësuesi i OE. ankues gjatë seancës, se e ka tejkaluar vlerën e parashikuar.Pra edhe në rastin hipotetik sikur të kthehej lënda në rivlerësim ankuesi në asnjë rrëthanë nuk do të mundej të hynte në garë dhe nuk do të mund të shpalje fitues i këtij aktiviteti të prokurimit , sepse i njejti me vetëdije përmes ofertës së tij ka bërë tejkalim të buxhetit të planifikuar nga ana e autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues, gjithashtu gjeti qe, autoriteti kontraktues, me datën: 05.12.2016, ka publikuar Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, në web -faqen e KRPP-së, ku në pikën 2.4 ka publikuar edhe Vlerën e parashikuar, ku për këtë aktivitet të prokurimit janë parashikuar: 52,000.00 euro, që do të thotë se të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës, duke përfshirë edhe vet OE. ankues kanë qenë të njoftuar rrëth vlerës së parashikuar të këtij aktiviteti të prokurimit, prandaj, paneli shqyrtues, konstaton dhe vlerëson se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës për shkelje të nenit 1, 59 dhe 61 të LPP-së, janë të paqëndrueshme dhe me këtë rast paneli shqyrtues, sqaron se AK-ja, me të drejt e ka eliminuar OE. ankues nga ky aktivitet i prokurimit

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

